

V E N D I M
Nr.45, datë 28.1.1999

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË SHËRBIMIT CIVIL

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr. 8095, datë 21.3.1996 “ Për shërbimin civil në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Koordinimit Qeveritar, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Anëtarët e komisionit të shërbimit civil (më poshtë Komisioni) propozohen nga Kryeministri dhe emërohen nga Këshilli i Ministrave.

2. Ministrinë, institucionet e tjera qendrore, organizatat joqeveritare dhe sindikatat paraqesin kandidatë për anëtarët e komisionit.

3. Anëtarë të komisionit mund të emërohen ata kandidatë, të cilët plotësojnë këto kushte:

- janë shtetas shqiptarë
- kanë mbushur moshën 30 vjeç
- kanë përvojë pune në profesionin e tyre, jo më pak se dhjetë vjetë,
- janë personalitete në fushat ku punojnë
- nuk janë të dënuar nga gjykata
- nuk e kanë humbur statusin e nëpunësit civil

4. Kryeministri emëron kryetar njërin prej anëtarëve të komisionit të shërbimit civil.

5. Kryetari i komisionit ka këto kompetenca:

- Thërret mbledhjet e zakonshme të komisionit, sipas rendit të ditës, të përcaktur më parë prej tij.

- Kontrollon veprimtarinë e nëpunësve civilë të autorizuar nga komisioni për ushtrimin e kompetencave të veçanta dhe i raporton për këtë komisionit.

- Koordinon punën me Departamentin e Administratës Publike.

- Drejton punën përgatitore teknike për mbledhjen e komisionit

- Drejton dhe organizon punën e sekretariatit të komisionit.

- Raporton, periodikisht, pranë Kryeministrit për veprimtarinë e komisionit. Raporti përmban një përmbledhje të punës së bërë, të rezultateve të arritura, përdorimin e buxhetit, objektivat e propozuara dhe kërkesat për buxhetin e vitit pasardhës. Ky raport publikohet në një gazetë kombëtare, me tirazh të lartë.

6. Komisioni bashkëpunon me Departamentin e Administratës Publike për:

- Politikat e hartuara nga ky departament për përshkrimin, klasifikimin dhe vlerësimin e vendeve të punës; konfirmimin, rekrutimin, përzgjedhjen, ngritjen në detyrë, masat disiplinore dhe vlerësimin e arritjeve të nëpunësve.

- Përgatit dhe publikon procedurat dhe manualët për politikën e mësipërme

- Politikën e përgjithshme të trajnimit dhe të programeve disavjeçare të trajnimit

- Miraton me shumicën e votave, të anëtarëve të tij, rregulloren e brendshme të funksionimit.

7. Komisioni mbledhet jo më pak se një herë në muaj dhe në raste të veçanta, me kërkesën e kryetarit ose të tre anëtarëve të komisionit.

8. Komisioni merr vendime, me shumicën e votave të anëtarëve të tij. Vendimet duhet të jenë të motivuara. Edhe vota kundër motivohet në relacionin i cili i bashkëlidhet vendimit të komisionit. Procesverbalet për diskutimet e komisionit mbahen nën përgjegjësinë e kryesekretarit dhe mund të bëhen këshillime nga çdo person i interesuar në mënyrë të drejtpërdrejtë, pas një kërkesë me shkrim.

9. Pranë komisionit krijohet sekretariat teknik, i cili kryen detyra të karakterit ndihmës, si:

- Përgatitjen e materialeve të mbledhjeve të komisionit, mbajtjen e procesverbaleve të mbledhjeve, zbardhjen e vendimeve të komisionit e detyra të tjera me karakter administrativ.

- Struktura e sekretariatit miratohet nga Kryeministri me propozimin e kryetarit të komisionit.

- Punonjësit e sekretariatit emërohen nga kryetari i komisionit.

10. Pagesa e anëtarëve të komisionit :

- Shpërblimi i anëtarëve të komisionit është i barabartë me 50 për qind të pagës së titullit

Profesor.

- Shpërblimi i kryetarit të komisionit është i barabartë me 70 për qind të pagës së titullit Profesor.

11. Komisioni financohet nga buxheti i shtetit dhe nga donatorë të ndryshëm.

Për vitin 1999, nga fondet e akorduara për Këshillin e Ministrave, komisionit i jepen 3 milionë lekë, në zërin “Paga dhe shpërblime”.

12. Në raste të veçanta, kur gjykohet e nevojshme nga shumica e anëtarëve, komisioni mund të kërkojë mendime nga ekspertë të fushave përkatëse.

13. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 99, datë 4.2.1998 “Për komisionin e shërbimit civil” shfuqizohet.

14. Ngarkohet Këshilli i Ministrave, i cili brenda datës 15 shkurt 1999, të nxjerrë udhëzimin përkatës për procedurat teknike për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të komisionit të shërbimit civil.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Pandeli Majko